



Prishtinë, 31 mars 2016
Kodi i ZRRE-së: V_800_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14, paragrafi 2, nënparagrafi 2.6, Nenin 25 dhe Nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe të tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së);
- Vendimin _V_797_1_2016 për të Hyrat E Lejuara Maksimale (MAR) që do të mbulohen nga operatori i licencuar i Termocentralit të Kosovës A dhe operatorit të licencuar të Termocentralit të Kosovës B (Gjeneratorët e Rregulluar);
- Vendimin e KOSTT_V_798_2016 për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut SH.A (KOSTT);
- Vendimin e OSSH_V_799_2016 për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Operatori i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);dhe
- Kërkesën e KESCO të dorëzuar me datën 21 janar 2016, në kuadër të Shqyrtimit të Dhjetë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE10) me dokumentacionin relevant sqarues.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, **në seancën e mbajtur më 31 mars 2016 nxori këtë:**



V E N D I M

- I. **APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR)** që do të mblidhen nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar që do të aplikohen nga **Furnizuesi Publik me energji Elektrike (KESCO)**, për vitin rregullativ tarifor SHTE10 (prill 2016-mars 2017).

ARSYETIM

- ✚ Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datën 21 janar 2016, ka pranuar nga KESCO- Furnizuesi Publik, Kërkesën për Përshtatjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale, që Furnizuesi Publik lejohet të mbledhë nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar.
- ✚ Me rastin e vendosjes për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Furnizuesi Publik, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
 - Vlerësimi përfundimtar –Detajet mbi Operatorin e sistemit të shpërndarjes dhe të furnizuesit publik, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Vlerësimi përfundimtar-Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Raport Konsultativ – Llogaritja e Blerjes me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar më datën 24 Shkurt 2016;
 - Raport Konsultativ-Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar, i publikuar me datën 24 shkurt 2016;
 - Raport Konsultativ - Llogaritja e MAR-it të KOSTT, i publikuar më datën 24 Shkurt 2016;
 - Raport Konsultativ - Llogaritja t e MAR-it të OSSH-së, i publikuar më datën 24 Shkurt 2016;
 - Raport Konsultativ - Llogaritja e MAR-it të FPPEE, i publikuar më datën 24 Shkurt 2016; dhe
 - Përgjigjet ndaj Komenteve - Shqyrtimi i dhjetë i tarifave të energjisë elektrike SHTE10, i publikuar me datën 31 mars 2016.
- II. Duke marrur parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje të këtij vendimi dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave relevante, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit Publik që mbulohen nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për vitin relevant tarifor SHTE10, pas përshtatjeve vjetore të rregullta të Hyrave Maksimale të Lejuara do të jenë **244,067,932 euro**.
- IV. Furnizuesi Publik përmes këtij Vendimi udhëzohet t'i përgatis dhe dorëzoj ZRRE-së propozimin për aprovim të tarifës së rregulluar me pakicë para vitit relevant tarifor.
- V. Tarifat dhe Ngarkesat e propozuara nga i licencuari duhet ndjekur parimet e vendosura në Rregullën për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike.



VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeve në mes të versioneve të përkthyer, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga Furnizuesi Publik duke filluar nga 1 prill 2016 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar,


Arsim Janova, anëtar,


Qemajl Mustafa anëtar,


Besim Sejfi, anëtar.

Vendimi iu dërgohet:

- Palës, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.